

# webertherm special G

## Ngjitës / rrafshues për EPS dhe XPS



### ■ Përshkrimi

**webertherm special G** është ngjitës i thatë, me bazë çimento gri, mbushës cilësorë dhe aditivë të përshtatshëm. Përdoret për ngjitjen dhe rrafshimin e paneleve izoluese të EPS dhe XPS.

### ■ Avantazhet

- Përgatitet dhe aplikohet lehtësisht
- Prodhuar nga lëndë të para cilësore
- Produkt 2në1 për ngjitje dhe rrafshim

### ■ Përdorimi

- për ngjitjen e paneleve izoluese prej EPS dhe XPS
- për rrafshimin e sipërfaqes së tyre për të krijuar shtresën e armuar ku aplikohet rrjeta e fasadës
- nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare

### ■ Përgatitja e bazamentit

- Bazamenti ku do të aplikohen panelet e izolimit termik duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash.
- Problemet e mundshme të bazamentit, duhet të riparohen para fillimit të punimeve.
- Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të papërshtatshme të motit

- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi +5°C dhe nën +30°C

### ■ Udhëzime mbi aplikimin

- Përmbytja prej 25kg e thesit përzihet me mikser elektrik duke e shtuar gradualisht në një enë me 6,5-7 l ujë të pastër, sipas nevojës.
- Pas përzjerjes së parë, masa lihet në prehje për rreth 10 min dhe më pas përzjehet përsëri para se të aplikohet.
- Përzjerja e përgatitur aplikohet në pjesën e pasme të paneleve izoluese të EPS apo XPS me anë të mallës, në formë shiriti në anë dhe tre pika të bollshme në mes të pllakës, në mënyrë që të mbulojë min 40% të sipërfaqes së panelit.
- Për ndërtesa me lartësi më të madhe se 3m, këshillohet përdorimi i upave të fasadës për fiksimin e paneleve në bazament, këshillohen 6 upa / m<sup>2</sup>
- Para rrafshimit të termoizolimit, kryhen përf forcime këndore rreth të gjitha hapjeve në fasadë, më pas vendosen aksesoret për përf forcimin e skajeve (këndore PVC me rrjetë, pikore horizontale, profile fundore etj.).
- Rrafshuesi aplikohet në termoizolim me mistri të dhëmbëzuar prej inoksi me thellësi 4 mm.
- Shtypni butësisht rrjetën me fibra qelqi në shtresën e ngjitësit të sapo aplikuar, duke u siguruar që mbivendosjet e rrjetës të jenë të paktën 10 cm të gjera. Rrjeta e fasadës duhet të pozicionohet të paktën në 1/3 por jo më shumë se 1/2 e trashësisë së shtresës rrafshuese, nga sipërfaqja.

*\*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*

# webertherm special G

## Ngjitës / rrafshues për EPS dhe XPS



### ■ Udhëzime mbi aplikimin

- Materiali që del përmes të çarave të rrjetës më pas nivelohet dhe pas tharjes së materialit, aplikohet shtresa perfundimtare rrafshuese e cila duhet të mbulojë plotësisht rrjetën.
- Shtresa perfundimtare dekorative mund të aplikohet 7 ditë pas aplikimit së shtresës së fundit të ngjitësit
- Masa e përgatitur duhet të konsumohet brenda jo më shumë se 6 orësh nga përgatitja

### ■ Siguria e produktit

- Përbërësit e rrezikshëm të përbërjes: çimento Portland



- Mund të çojë në dëmtime të rënda të syrit. Shkakton acarim të lëkurës. Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës. Mund të shkaktojë acarim të organeve të frymëmarrjes. Vishni doreza mbrojtëse, rroba mbrojtëse, syze mbrojtëse dhe mbrojtje për fytyrën. **NË RAST KONTAKTI ME SYTË:** Shpëlajeni me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse ka, dhe nëse është e mundur. Vazhdoni të shpëlani. Telefononi menjëherë QENDRËN E KONTROLLIT TË HELMIMIT ose kontaktoni një mjek. **NË RAST KONTAKTI ME LËKURËN:** Shpëlajeni me ujë të bollshëm dhe sapun. **NË RAST THYMËRI:** Çojeni personin në ajër të pastër dhe vendoseni në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen.
- Përmbajtja e kromit të tretshëm Cr (VI) në produkt është më pak se 0.0002% e llogaritur në masën totale të çimentos së thatë

### ■ Veglat

Përgatitja: mikser elektrik, enë për përzierje.  
Aplikimi: mallë çeliku, shpatull.

### ■ Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga ngrica.

### ■ Asgjësimi

Produkti i papërdorur dhe paketimi bosh nuk mund të hidhen jashtë hapësirave të menaxhimit të mbetjeve. Shikoni fletën e të dhënave të sigurisë së produktit dhe kërkesat legjislative për më shumë informacion.

*\*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*



# webertherm special G

## Ngjitës / rrafshues për EPS dhe XPS

Tabela e te dhenave teknike

Lloji i paketimit	thes letre	
Sasi per njesi	25 kg / paketim 1350 kg / paletë	54 thase / paletë
Ngjyra	gri	
Kokerrzimi	0.6 mm	
Konsumi	6-7 kg/m <sup>2</sup> ngjitje 4-5 kg/m <sup>2</sup> rrafshim 10 - 12 kg/m <sup>2</sup> total	Te dhenat mbi konsumin jane orientuese dhe ne varesi te karakteristikeve te bazamentit dhe teknikes se aplikimit.
Konsumi i ujit	6,5-7 l	
Trashesia e shtreses (rrafshuese)	2 - 4 mm	

Treguesit fiziko-mekanike

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	NJESIA MATESE
Masa vellimore ne gjendje te shkrifet	1.30 -1.40	Gr/m <sup>3</sup>
Mbjetje ↓ 180 μ	53	%
Uje-mbajtja	99	%
Masa vellimore e llaçit ne 20°C	1600-1700	Kg/L
Gjendja	Pluhur	

Treguesit kimike

Lageshtira	0.1	%
Aditive	1.5	%

\*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.